

Data 21.06.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Blerje vajra minerale dhe graso për motorrë dhe komponentë mekanik, antifrizë

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

24951100-6; 24951100-5

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi Limit 8.585.033 (tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 në vlerën 171.701 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind e një). Lekë*

c. *Formularin e ofertës sipas shtojcës 1 dhe 2*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë Licencë të kategorisë IV/A të vlefshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar

*(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2021 dhe 2022 ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë sa 20 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Seksionit III, Neni 43 pika 2 dhe neni 55 pika 4

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021 dhe 2022 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

*(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate *(apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 55, pika 4/b ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

#### **2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

- 2.4.1. Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë Certifikim ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001-2018, të vlefshme, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.
- 2.4.2. Per te gjithë produktet duke përfshirë vetëm produktet Graso Speciale, Graso Vetëgrasatuese dhe Alkol freni , Operatori Ekonomik të paraqesë raport Analizë të lëshuar nga autoriteti perkates i autorizuar dhe akredituar, ISHTI , ku vlerat e Raport Analizës të jenë brenda kufijve të vlerave të kerkuara në DST referuar Shtojcës 5 dhe 6. Produkti AdBlue duhet të jetë i shoqëruar me Raport Analizë nga Laborator i Akredituar ose Laboratori i Prodhuesit.

Nëse raport analizat janë të lëshuara nga Laboratori i prodhuesit, në këtë rast të shoqërohen me certifikatë Akreditimi të Laboratorit nga Organizma Ndërkombëtar sipas standartit EN ISO/IEC 17025, e cila të jetë origjinale ose kopje e noterizuar dhe përkthyer në gjuhën shqipe.

- 2.4.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar dhe Katalog Origjinal për të gjithë produktet e ofruara i cili të ketë specifikimet teknike dhe treguesit cilësor në përputhje me specifikimet teknike. Autorizimi nga Prodhuesi duhet të përmbajë kontaktet e plota të prodhuesit (adresë, telefon, e-mail) në rast verifikimi.
- 2.4.4. Ditën dhe orën e hapjes së Ofertave subjekti Ofertues të paraqesë nga një mostër për të gjithë produktet të cilat duhet të jenë me mbyllje fabrike dhe etikete fabrike jo

etiketë të bërë nga subjekti Ofertues. Në etiketë të jenë të shënuara të gjithë specifikimet teknike të produktit sipas Tabelës në Shtojcën 5 dhe 6, të kërkuar nga AK.

2.4.5. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin e mallit të kërkuar në objektin e DST pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve, sasisë dhe specifikimeve të përcaktuara sipas Tabelës së Shtojcës 6.

2.4.6. Për të gjithë produktet të ofrohet me tabelë si më poshtë:

Operatori ekonomik të paraqesë katalogë origjinale të produkteve, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën e specifikimeve teknike të DST. Katalogët duhet të shoqërohen me një listë sipas tabelës së përgjithshme ku të specifikohen të dhënat si vijon:

Nr.	Emertimi i artikullit	Njësia	Sasia	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Numri i faqes në katalog	Linku i produktit	Standarti i Cilësisë
-----	-----------------------	--------	-------	------------------------------	----------------------	--------------------------	-------------------	----------------------

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërish çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërmat a,b,c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose*

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike si në tabelen e poshtme është kryer duke iu referuar blerjeve të mëparshme, kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor Eco Tirana sh.a. në fushën e veprimtarisë së tij.

ARTIKULLI/ ARTICOLO	PERSHKRIMET/SPERCFIKIMET TEKNIKE DESCRIZIONE /SPECIFICHE TECNICHE	NJESI MATESE/ UNITA' DI MISURA	SASIA/ QUANTITA'
<b>Graso Litium</b> (-20°C +130°C)	<b><u>Graso me baze litiumi Klasa NLGI-2,</u></b> Temperatura e aplikimit -20°C deri në 130°C. Pika e penetrimit gjatë punës në 25°C =240-270°C, Temperatura pikimit 200°C-220°C	Kg	600
<b>Graso Litium</b> Vetegasatuese LIC 000 (-50°C +120°C)	<b><u>Graso me baze litiumi Klasa NLGI-00 /000</u></b> <b><u>DIN 51 502, GP00/000K-50</u></b> Temperatura e aplikimit -50°C deri në 120°C.	Kg	150
<b>Graso sintetike Litium Complex Speciale</b> (-40°C +160°C)	<b><u>Graso Speciale Sintetike Litium Complex Klasa NLGI-2 DIN 51 502,KPHC2P-40</u></b> Temperatura e aplikimit -40°C deri në 160°C. Te paraqitet katalog Prodhuesi	Kg	20
<b>Vaj motorri 5W-30</b>	<b><u>Vaj motorri 5W-30, SAE API SJ-4/SN,ACEA E6/E7/E9</u></b>  Densiteti me 15°C të jetë 849-856 kg/m <sup>3</sup> .	Litra	800

	<p>Permbajtje uje nuk ka.</p> <p>Viskoziteti ne kinematik ne 100°C te jete 8.2-12mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Viskozitet ne 150°C te jete mPa*s≥3.6.</p> <p>Pika e ngrirjes -30°C:-45°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit min.230-240°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 125-170.</p> <p>Permbajtja e hirit max.0.028-0.96%.</p>		
<p><b>Vaj motorri 5W-30 per Iveco Daily</b></p>	<p><b><u>Vaj motorri 5W-30, API SN/CF, ACEA C2, A5/B5, IVECO, Fiat 9.55535-S1.</u></b></p> <p>Densiteti me 15°C te jete 849-856 kg/m<sup>3</sup>.</p> <p>Permbajtje uje nuk ka.</p> <p>Viskoziteti Min. 40°C te jete 60-102 mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Viskoziteti ne kinematik ne 100°C te jete 8.2-12mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Pika e ngrirjes -30°C:-45°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit min.230-250°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 125-170.</p> <p>Permbajtja e hirit max.0.028-0.07%.</p>	Litra	100
<p><b>Vaj motorri 5W-40 Per Smart</b></p>	<p><b><u>Vaj motorri 5W-40, SAE API SP/CF, ACEA A3/B4,</u></b></p> <p>Densiteti me 15°C te jete 849-860 kg/m<sup>3</sup>.</p> <p>Permbajtje uje nuk ka.</p> <p>Viskoziteti ne kinematik ne 100°C 8.2-12mm<sup>2</sup>/s.</p>	Litra	40

	<p>Pika e ngrirjes -30°C:-45°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit min. 230-240°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 125-170.</p>		
<b>Vaj Motori 10W-40</b>	<p><b><u>Vaj motorri 10W-40, SAE API CI-4/SL,ACEAE7/A3/B4</u></b></p> <p>Densiteti me 15 °C te jete 860-890 kg/m3.</p> <p>Permbajtje uje nuk ka.</p> <p>Viskoziteti Min. 40°C te jete 85-102 mm2/s.</p> <p>Viskoziteti kinematik ne 100°C te jete 11-15 mm2/s.</p> <p>Viskoziteti ne 150°C te jete mPa*s mPa*s≥3.5.</p> <p>Pika e ngrirjes -30°C-40°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit min 230-242°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 120-165.</p> <p>Permbajtja e hirit % max. 0.070</p>	Litra	800
<b>Vaj hidraulik 46</b>	<p><b><u>Vaj Hidraulik 46, DIN 51524-2(HLP) DIN ISO 6743-4 (HM).</u></b></p> <p>Densiteti 15°C te jete 0.850-0.880 g/cm3.</p> <p>Permbajtje uje nuk ka.</p> <p>Viskoziteti ne 40°C 44.8-46.5 mm2/s.</p> <p>Viskoziteti kinematik ne 100 te jete 6.5-7.2 mm2/s.</p>	Litra	5000

	<p>Pika e ngrirjes -24°C -35°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit 230°C-268°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 90-100</p>		
<b>Vaj motorri 15W-40</b>	<p>Vaj motorri SAE 15W-40, API CF-4/CF/SH, ACEA E-2</p> <p>Densiteti 15°C te jete 0.880-0.890 g/cm3.</p> <p>Permbajtje uje nuk ka.</p> <p>Viskoziteti ne 40°C 95-130 mm2/s.</p> <p>Viskoziteti kinematik ne 100 te jete 12-15.7mm2/s.</p> <p>Pika e ngrirjes -26°C -28°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit 230°C-250°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 110-145</p> <p>Permbajtja e hirit % max. 0.1</p>	Litra	400
<b>Vaj motorri 20W-50</b>	<p>Vaj motorri SAE 20W50, API CF-4/CF/SG</p> <p>Densiteti 15°C te jete 0.880-0.892 g/cm3.</p> <p>Permbajtje uje nuk ka.</p> <p>Viskoziteti ne 40°C 165-177 mm2/s.</p> <p>Viskoziteti kinematik ne 100 te jete 15-20mm2/s.</p> <p>Pika e ngrirjes -24°C -28°C.</p>	Litra	60

	<p>Temperatura e flakerimit 238°C-260°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 90-130.</p> <p>Permbajtja e hirit % max. 0.09.</p>		
<b>ALKOL DOT-4</b>	<p>Alkol Freni DOT-4 SAJ 1703, FMVSS 116</p> <p>Densiteti me 15 °C te jete 1.06-1.07 g/ml.</p> <p>Permbajtje uji nuk ka.</p> <p>Viskoziteti kinematik ne 100 °C te jete 1.5-4 mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Pika e vlimit min. 230-400 °C.</p>	Litra	60
<b>ANTIFRIZE Koncentrat</b>	<p>ANTIFRIZE Koncentrat ,SAJ 1034,BS 6580</p> <p>Densiteti me 15 °C te jete 1.10-1.125 g/ cm<sup>3</sup>.</p> <p>Pika e ngrirjes °C %100 -23°C-25°C</p> <p>Pika e vlimit °C %100 160°C-165</p> <p>Temperatura e flakerimit Min. 125°C.</p> <p>PH 20 °C %100 te jete 8-8.5.</p>	Litra	200
<b>VAJ KAMIO SAE 80W90</b>	<p>SAE 80W90 API GL-4,MIL-L-2105</p> <p>Densiteti me 15 °C te jete 0.850-0.895 g/ml.</p> <p>Permbajtje uji nuk ka.</p> <p>Viskoziteti Min. 40°C te jete 150-155 mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Viskoziteti kinematik ne 100 °C te jete 14-15.3 mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Pika e ngrirjes -24°C-30°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit min. 210°C-240°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 90-110.</p> <p>Permbajtja e hirit % max. 0.04.</p>	Litra	120

<p><b>Vaj per Grup Timoni</b></p>	<p>Vaj per Grup Timoni G004 000, G002 012, G052146,MB 236.3/345.0</p> <p>Densiteti me 15 °C te jete 0.860-0.880 g/ml.</p> <p>Permbajtje uji nuk ka.</p> <p>Viskoziteti Min. 40°C te jete 26-40 mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Viskoziteti kinematik ne 100 °C te jete 6.0 -7.5 mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Pika e ngrirjes -30°C -42°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit min. 200-225 °C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 150-176.</p> <p>Permbajtja e hirit % max. 0.09.</p>	<p>Litra</p>	<p>180</p>
<p><b>Vaj ATF DX-3</b></p>	<p>Vaj ATF III,Dexron III H,GM Allison C4,MB 236.1/236.9</p> <p>Densiteti me 15 °C te jete 0.850-0.880 g/ml.</p> <p>Permbajtje uji nuk ka.</p> <p>Viskoziteti Min. 40°C te jete 26-40 mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Viskoziteti kinematik ne 100 °C te jete 6.0 - 7.8mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Pika e ngrirjes -30°C -45°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit min. 180-225 °C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 150-176.</p> <p>Permbajtja e hirit % max. 0.09.</p>	<p>Litra</p>	<p>60</p>
<p><b>VAJ Kompresori VDL100</b></p> <p><b>DIN 51506 VDL,ISO 6743-3</b></p>	<p>VAJ Kompresori VDL 100,DIN 51506 VDL,ISO 6743-3</p> <p>Densiteti me 15 °C te jete 0.868-0.890g/ml.</p> <p>Viskoziteti ne 40°C te jete 87-100 mm<sup>2</sup>/s.</p>	<p>Litra</p>	<p>20</p>

	<p>Viskoziteti kinematik ne 100 °C te jete 8.5-11.3mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Pika e ngrirjes -18-30°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit min. 235-268 °C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 96-115.</p> <p>Permbajtja e hirit % max. 0.04.</p>		
<b>ADBLUE</b>	<p>ADBLU ISO 22241-1,DIN 70070</p> <p>Permbajtja e urese % (m/m) 31.8-33.2</p> <p>Densiteti ne 20°C 1.087-1.093 g/ml</p> <p>Indeksi Refraktiv 1.38-1.39</p> <p>Alkaliniteti NH<sub>3</sub> % (m/m) max 0.2</p> <p>Biuret ne % (m/m)max 0.3</p> <p>Aldehidet mg/kg max 5.0</p> <p>Isolubles mg/kg max 20</p>	Litra	10000
Vaji Sintetik per Kamio Iveco SAE 75W80SL	<p>Vaji Fully Syntetik per Kamio</p> <p>Iveco SAE 75W80SL, Iveco, Man 341-E3/Z4,</p> <p>Volvo 97305,ZF TE-ML 01L, 02L, 16K, 08</p> <p>Densiteti me 15 °C te jete 0.857-0.860kg/m<sup>3</sup>.</p> <p>Viskoziteti aparent ne -40°C te jete 65.000 mPas.</p> <p>Viskoziteti kinematik ne 100 °C te jete 9.4-9.5 mm<sup>2</sup>/s.</p> <p>Pika e ngrirjes -40°C-45°C.</p> <p>Temperatura e flakerimit min. 240 -250°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 150-155.</p>	Litra	100

	Permbajtja e hirit % max. 0.03.		
--	---------------------------------	--	--